



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

*Ministria e Zhvillimit Ekonomik*  
*Ministarstvo Ekonomskog Razvoj – Ministry of Economic*  
*Development*

**Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike**

*Vlerësimi i Efektshmërisë së Punës së*  
*Bordeve të Drejtorëve të NP-ve Qendrore*  
*për Vitin 2010*

---

*Nëntor 2011*

## Përmbledhje

Hyrje .....	4
Qëllimi i Vlerësimit .....	4
Baza për Vlerësim .....	5
Burimet e Informacionit .....	5
Metodologjia e Vlerësimit .....	5
Përmbledhje e Vlerësimit të Performancës së NP-ve dhe Efektshmerisë së BD .....	6
Grupi i Bordeve të Drejtorëve që kanë Përbushur në Tërësi Detyrat Fiduciare ndaj Aksionarit: ....	6
A.    KOSTT .....	6
B.    HS Ibër Lepenci .....	6
C.    KRU Prishtina .....	7
D.    Korporata Energjetike e Kosovës .....	8
Grupi i Bordeve të Drejtorëve me Arritje të Pjesshme dhe Përbushje jo të plotë të Detyrave Fiduciare ndaj Aksionarit .....	9
A.    Hekurudhat e Kosovës .....	9
B.    Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” .....	9
C.    KRU HidroMorava-Gjilan .....	10
D.    KRU HidroRegjioni Jugor-Prizren .....	11
E.    KU Radoniqi-Dukagjini-Gjakovë .....	11
F.    Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës - PTK .....	12
Grupi i Bordeve të Drejtorëve që nuk i kanë Përbushur Detyrat Fiduciare ndaj Aksionarit .....	13
A.    KRU HidroDrini-Pejë .....	13
B.    KRU Mitrovica .....	14
C.    KRU Radoniqi-Gjakovë .....	14
D.    KU Drini i Bardhë - Pejë .....	15
E.    Kompania për menaxhimin e deponive të mbeturinave në Kosovë – KMDK.....	16

## Lista e Shkurtesave

MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QK	Qeverisja Korporative
NP	Ndërmarrje Publike
KOSTT	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu
HS	Hidrosistemi
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
KEK	Korporata Energetike e Kosovës
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
BD	Bordi i Drejtorëve
KA	Komisioni i Auditimit
PB	Plani i Biznesit
LNP	Ligji mbi Ndërmarrje Publike
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
MWh	Mega Wat për orë (Njësi elektrike)
ZM	Zyra e Ministrit
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
KU	Kompania e Ujitjes
HK	Hekurudhat e Kosovës

## Hyrje

Me miratimin e Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 në qershor të vitit 2008, kompetencat lidhur me përgjegjësitë dhe pronësitë e Ndërmarrjeve Publike në tërësi kanë kaluar nga institucionet ndërkombëtare tek institucionet e Republikës së Kosovës.

Në Kosovë funksionojnë 31 Ndërmarrje Publike, nga të cilat 15 janë Ndërmarrje Publike Qendrore me aksionar Qeverinë e Kosovës, në emër të Popullit të Kosovës, si dhe 16 të tjera janë Ndërmarrje Publike Lokale, me aksionarë Komunitetet e Kosovës, ku të gjitha përgjegjësitë mbi monitorimin dhe funksionimin e tyre i kanë Komunitetet përkatëse.

Ligji mbi Ndërmarrjet Publike, përkatësisht neni 37, ka mundësuar edhe themelimin e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike-NJPMNP, kështu që NJPMNP funksionon në kuadër të MZHE-së dhe është themeluar me qëllim të mbështetjes së Ministrisë përgjegjëse dhe Qeverisë në ushtrimin e përgjegjësisë për Ndërmarrje Publike, aksionar i të cilave është Qeveria.

NJPMNP, po ashtu do të përgatisë për ministrin përgjegjës analiza, procedura e rekomandime për transmetim në Qeveri, lidhur me çështjet e Ndërmarrjeve Publike Qendrore, të cilat janë në kompetencën e Ministrisë dhe Qeverisë. NJPMNP, gjithashtu do të përgatisë propozim-procedura për monitorimin dhe mbikëqyrjen e Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Në nenin 17 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike përcaktohet që Aksionarët në një Ndërmarrje Publike do të ushtrojnë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë të veprimtarisë së Bordeve të Drejtorëve, mirëpo neni 7 pika 6 e përcakton që kjo mbikëqyrje nuk do të ushtrohet në një mënyrë që ndërhyt ose ka për qëllim të ndërhyt në pavarësinë e Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit.

## Qëllimi i Vlerësimit

Me Ligjin mbi Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, neni 28 pika 3, NJPMNP obligohet që në baza vjetore ta vlerësojë efektshmërinë e punës së Bordeve të Drejtorëve të secilës Ndërmarrje Publike Qendrore dhe pas finalizimit, raporti do të publikohet në Ueb faqe të NJPMNP-së.

Duke pasur parasysh se lëmia e Qeverisjes së Korporatave është lëmi e re në Kosovë, si dhe përvojat për këtë nuk janë të mjaftueshme, por Ligji ka mundësuar që të angazhohen këshilltarë të jashtëm. Për këtë arsye, NJPMNP me ndihmën financiare të Zyrës Zvicerane, është mbështetur nga një këshilltar i jashtëm në mënyrë që ta finalizojë procesin e Vlerësimit të Efektshmërisë së punës së Bordeve.

NJPMNP ka qenë e interesuar të përcaktojë progresin e Ndërmarrjeve Publike (NP) në sektorët e energjisë, telekomunikacionit, transportit, ujërave e mbetjeve urbane gjatë 2010, në zbatimin e përmirësimeve ligjore të parashikuara në Ligjin për NP, lidhur me Qeverisjen Korporative (QK).

Gjithashtu, NJPMNP gjatë Vlerësimit ka arritur ta përcaktojë efektshmërinë e punës së Bordeve të Drejtorëve si ndikim i drejtpërdrejtë në progresin e arritur nga Ndërmarrja Publike e në përputhje me politikën e strategjitë e zbatuara në përmirësim të performancës së QK, duke marrë parasysh normat dhe standardet evropiane.

## Baza për Vlerësim

Elementet bazë për kryerjen e Vlerësimit të Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike kanë qenë aktivitetet si më poshtë:

- Shqyrtimi i aktivitetit të tanishëm të NP-ve;
- Shqyrtimi i treguesve të efijencës operationale të përdorur nga menaxhimi i NP-ve, krahasuar me treguesit e Planit të Biznesit, (PB), të aprovuar nga BD;
- Rishikim i efijencës së punës së BD, aftësisë për të marrë vendime në interes të ndërmarrjes e në respektim të kuadrit ligjor e rregullator;
- Shqyrtim dhe vlerësim i performancës së Bordit dhe Komitetit të Auditimit (KA) lidhur me përgjegjësinë e tyre të monitorimit të zbatimit të PB, miratuar prej tyre, respektimin e ligjshmërisë dhe krijimin e një sistemi të brendshëm kontrolli që optimizon përdorimin sa më efijentë të burimeve, mundëson ruajtjen e tyre, si dhe transparencë dhe arsyeshmëri ekonomike (për interesa më të mira ndaj aksionarit) në vendimmarrje;
- Rishikim i zbatimit të praktikave më të mira të QK, duke iu referuar Kodit të Etikës së QK në NP, duke nënvizuar detyrimin e raportimit ndaj Aksionarit.

## Burimet e Informacionit

- Dokumente të kërkuara nga Implementimi i detyrimeve që dalin nga Ligji mbi NP, posaçërisht kërkesat nga neni 29,30,31,35,36 dhe komunikimi me Aksionarin;
- Raporti Vjetor i NP gjegjëse;
- Raportet e Zyrave Rregullative;
- Raportet e Auditimit të jashtëm apo Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;
- Dokumentet që dalin nga funksionimi i Qeverisjes korporatave, si Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit, apo Komisionit të Auditimit, Vendimet e Bordit dhe dokumente tjera relevante.

## Metodologjia e Vlerësimit

Shqyrtimi i dokumentacionit do të përcaktojë nivelin e respektimit të LNP-së dhe veçanërisht të artikujve 29, 30, 31, 35 dhe 36, akteve të tjera nënligjore, si modelet e lëshuara nga Aksionari dhe propozim të procedurave e shkresave të Aksionarit. Po ashtu, do të nxjerrë në pah efektshmërinë e drejtimit dhe menaxhimit të NP-së, përkundrajt treguesve të Planit të Biznesit të miratuar nga BD.

Qëllimi i analizës është identifikimi i aftësisë dhe korrektësisë së BD në kryerjen e punës së tij dhe vënia në pah, përveç pikave të forta, e ndonjë mungese, mospërputhjeje, mosplotësie niveli të dëshirueshëm cilësie, argumenti e prezantimi, koherence, përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit dhe monitorimit, si dhe ndonjë mbivendosje, vakumi apo përplasje autoritetesh a përgjegjësish.

## Përmbledhje e Vlerësimit të Performancës së NP-ve dhe Efektshmërisë së Bordeve të Drejtorëve

Në vijim të mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave të performancës operacionale e financiare, si dhe Qeverisjes Korporative në NP, bazuar në punën e NJPMNP dhe mbështetur nga konsulenca e jashtme, më poshtë përmbledhet vlerësimi i efektshmërisë së performancës së Bordeve të Drejtorëve:

### Grupi i Bordeve të Drejtorëve që kanë Përbushur në Tërësi Detyrat Fiduciare ndaj Aksionarit:

#### A. Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Ramadan Pacarda	24.12.2008	23.12.2011
Faton Deda	24.12.2008	23.12.2011
Lutfi Maxhuni	24.12.2008	23.12.2011
Nazim Mikullovc	24.12.2008	23.12.2011
Fatos Ukaj	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi janë pozitivë, në krahasim me caqet nga plani i biznesit si: ndërprerjet në transmision në min/vit janë më të vogla se pritjet nga caqet e PB, si dhe viti paraprak. Humbjet në transmision të energjisë janë ulur për 30% nga viti paraprak, apo zvogëlim të humbjeve në transmision për 55% nga caqet e PB.

**Performanca Financiare** dhe treguesit financiarë, gjithashtu janë pozitivë në krahasim me caqet nga PB dhe viti paraprak si: të ardhurat totale në 2010 janë më të mëdha se viti paraprak për 7%, apo 19% më të larta se caqet nga PB, dhe nga kjo ngritje e performances rrjedhë edhe fitimi prej afro 3.5 mil Euro.

**Qeverisja Korporative** dhe respektimi i rregullativave ligjore është një ndër përparësitë më të mëdha në funksionimin e Bordit, duke respektuar kërkesat nga Implementimi i Ligjit mbi NP dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, duke përfshirë këtu raportimet e rregullta ndaj aksionarit dhe komunikimin e rregullt me NJPMNP.

#### B. HS Ibër Lepenci

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Nazmi Zenelaj	24.12.2008	23.12.2011
Ilmi Ahmeti	24.12.2008	23.12.2011
Faton Gyshinca	24.12.2008	23.12.2011
Murat Meha	24.12.2008	23.12.2011
Bajram Mustafa	24.12.2008	23.12.2011

Gjelosh Vataj	24.12.2008	23.12.2011
---------------	------------	------------

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi janë pozitiv në krahasim me caqet nga plani i biznesit si: uji i furnizuar në m<sup>3</sup> është për 41% më i lartë se vitin paraprak dhe 5% më shumë se caqet nga PB, energjia e gjeneruar në MWh në 2010 ishte 24% më e madhe se në 2009 dhe 24% më shumë se caqet e parapara nga PB.

**Performanca Financiare** dhe treguesit financiarë, gjithashtu janë pozitivë në krahasim me caqet nga PB dhe viti paraprak si: Totali i të ardhurave ishte për 24% më i lartë se në vitin paraprak, apo 15% mbi caqet nga PB, ku fitimi operativ në euro (pa zbritur shpenzimet e zhvlerësimit) ishte për 35% më i lartë se viti paraprak dhe 49% më i lartë sesa caku nga PB.

**Qeverisja Korporative** dhe respektimi i rregullativave ligjore është një ndër përparësitë më të mëdha në funksionimin e Bordit, duke respektuar kërkesat nga Implementimi i Ligjit mbi NP-të, Kodit të Etikës, si dhe Qeverisjes Korporative, duke përfshirë këtu raportimet e rregullta ndaj aksionarit dhe komunikimin e rregullt me NJPMNP.

### C. KRU Prishtina

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Ejup Hashani	24.12.2008	23.12.2011
Bajram Jashari	24.12.2008	23.12.2011
Adem Duriqi	24.12.2008	23.12.2011
Kujtim Xhelili	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi janë pozitiv, në krahasim me caqet nga Plani i Biznesit si: Prodhimi i ujit në m<sup>3</sup> është më i lartë se në vitin paraprak për 1% dhe 3% më i lartë se caku i paraparë në PB, përqindja e inkasimit nga faturimi i ujit është për 4% më i lartë nga viti 2009 dhe 2% më i lartë nga caku i paraparë në PB, rritja e numrit të konsumatorëve për 5600 nga viti paraprak dhe tejkalim i caktut nga PB për 3900 konsumatorë.

**Performanca Financiare** dhe treguesit financiarë, gjithashtu janë pozitivë në krahasim me caqet nga PB, si dhe nga viti paraprak si: Rritja e të hyrave për 13% nga viti paraprak dhe zvogëlimi i humbjes financiare nga viti paraprak për 15%, apo për 354 mijë euro.

**Qeverisja Korporative** dhe respektimi i rregullativave ligjore është një ndër përparësitë më të mëdha në funksionimin e Bordit, duke respektuar kërkesat nga implementimi i Ligjit mbi NP-të, Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, duke përfshirë këtu raportimet e rregullta ndaj aksionarit dhe komunikimin e rregullt me NJPMNP.

#### D. Korporata Energjetike e Kosovës - KEK

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Fadil Çitaku	24.12.2008	23.12.2011
Izet Ibrahim	24.12.2008	23.12.2011
Ismail Jonuzi	24.12.2008	23.12.2011
Flamur Keqa	24.12.2008	23.12.2011
Agim Nika	24.12.2008	23.12.2011
Mujë Rugova	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi për disa indikatorë janë pozitiv në krahasim me caqet nga Plani i Biznesit si: Totali i prodhimit të energjisë në MWh për 4% më shumë se në vitin paraprak, apo 2% më shumë se caqet nga PB. Prodhimi i tëngjillit për 1.5% më shumë nga viti paraprak, gjegjësisht 119 mijë ton më shumë. Inkasimi i energjisë së faturuar për 8% më shumë se në vitin 2009, apo nga 80 në 88%, si dhe zvogëlimi i humbjeve teknike për 1.22%, por në përgjithësi të KEK treguesit operacional kanë përmirësim të dukshëm nga 2009, por gjithsesi mbetet sfidë e arritjes së buxhetit në zërat e humbjeve komerciale.

**Performanca Financiare** dhe treguesit financiar, gjithashtu janë pozitivë në krahasim me caqet nga PB dhe viti paraprak si: Rritja e të hyrave për 10% nga viti paraprak, apo tejkalim i caqeve nga PB për 3%, si dhe rritja e fitimit financiar, sipas Raportit të ZAP, nga 5 milionë në 2009, në 14 milionë në vitin 2010.

**Lidhur me çështjet e Qeverisjes Korporative**, drejtuesit e KEK përgjithësisht kanë plotësuar detyrimet e tyre ligjore dhe kjo ishte një ndër përparësitë më të mëdha në funksionimin e Bordit, duke respektuar kërkesat nga Implementimi i Ligjit mbi NP-të, Kodit të Etikës, si dhe Qeverisjes Korporative, duke përfshirë këtu raportimet e rregullta ndaj aksionarit dhe komunikimin e rregullt me NJPMNP. Ndër çështjet më pozitive të këtij BD është roli shumë pozitiv i luajtur nga një ekip profesional i komisionit të auditimit, i cili në bashkëpunim me auditorin e brendshëm ka funksionuar shumë mirë në identifikimin dhe ndjekjen e problemeve të sistemit të kontrollit të brendshëm, raportimit, respektimit të kuadrit rregullator dhe ngritjen e institucionit të përgjegjshmërisë.



## Grupi i Bordeve të Drejtorëve me Arritje të Pjesshme dhe Përmbushje jo të plotë të Detyrave Fiduciare ndaj Aksionarit

### A. Hekurudhat e Kosovës – HK

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Sejdi Hoxha	24.12.2008	23.12.2011
Halil Kikaj	24.12.2008	23.12.2011
Fadil Krasniqi	24.12.2008	23.12.2011
Halim Peci	24.12.2008	23.12.2011
Agron Thaqi	24.12.2008	23.12.2011
Hysen Fazliu	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi janë pozitivë si: shtimi i numrit të udhëtarëve për 0.3% nga viti 2009, por nën caqe nga Plani i Biznesit për 1%, rritja e transportit të mallrave përmes Hekurudhave për 20% më shumë se në vitin paraprak dhe tejkalim të caqeve të biznesit për 27%.

**Performanca Financiare** dhe treguesit financiarë, janë të luhatshëm në krahasim me caqet nga PB dhe viti paraprak si: Rritja e të ardhurave totale për 2.7% në krahasim me 2009, por edhe në këtë ndërmarrje arritja e caqeve nga plani i biznesit për mbetet sfidë. Rritja e shpenzimeve është për 14% më e lartë në krahasim me vitin 2009 por zvogëlim të konsiderueshëm të humbjeve financiare për 290 mijë Euro nga viti 2009. Humbja neto financiare për vitin 2010 në këtë ndërmarrje është 65 mijë Euro.

**Nga aspekti i Qeverisjes Korporative** dhe respektueshmërisë së rregullativave ligjore, Bordi ishte në nivel të duhur. Me një punë ekipore dhe angazhim profesional bordi ka identifikuar problemet, duke marrë parasysh prirjen pozitive të performancës operative dhe dinamikën e projekteve të zhvillimit, si edhe respektimin e dispozitave që rrjedhin nga LNP në plotësim të detyrave fiduciare të Aksionarit, duhet inkurajuar në fuqizimin e funksionalitetit të tij.

### B. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës - ANP “Adem Jashari”

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Bekim Jashari	24.12.2008	23.12.2011
Naser Canolli	24.12.2008	23.12.2011
Besnik Krasniqi	24.12.2008	23.12.2011
Fejzullah Krasniqi	24.12.2008	23.12.2011
Hanefi Muharremi	24.12.2008	23.12.2011
Bislim Zogaj	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi për 2010 janë pozitivë si: numri i udhëtarëve që kalojnë përmes ANP tejkalon vitin 2009 për 6%, ndërsa tejkalon edhe caqet nga Plani i Biznesit për 6%, sikurse edhe numri i aeroplanëve të ateruar më 2010, i cili ka tejkaluar aterimet në 2009 për 9%, apo tejkalim i caqeve nga Plani i Biznesit për 9%.

**Performanca Financiare** në këtë ndërmarrje përmbillet me fitim financiar prej 6.1 milionë Euro, megjithatë ky ishte një fitim relativisht më i ulët se në vitin paraprak. ANP nuk ka arritur cakun nga Plani i Biznesit për një fitim të dëshirueshëm prej 8.9 milionë euro, pasi kishte indikatorë financiar jo të volitshëm si: të ardhura totale më të vogla se në 2009 për 800 mijë euro dhe kosto më të madhe se në vitin paraprak prej 4 milionë euro, ku nga këto: kosto të pagave prej 1.6 milion euro dhe kosto të tjera operative më të larta prej 2.5 milionë euro.

**Qeverisja Korporative** dhe respektimi i rregullativave ligjore, me tërë angazhimin e ekipit të Bordit, nuk ishin në nivelin e asaj të vitit paraprak, ndërsa kishte shumë vend për një pëkushtueshmëri më të lartë tek punimi dhe implementimi i Deklaratës mbi politikën e kompensimit, sikurse që kishte një nevojë për një angazhim më të madh të komisionit të auditimit.

### C. KRU Hidromorava - Gjilan

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Avdyl Hasani	24.12.2008	23.12.2011
Azem Mujku	24.12.2008	23.12.2011
Xhelal Selmani	24.12.2008	23.12.2011
Elhame Shefkiu	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe disa treguesi që dalin nga operimi janë pozitivë si: rritja e vëllimit të ujit në m<sup>3</sup> për 7% nga viti paraprak, shkalla e arkëtimit nga faturimi për 5% më shumë apo nga 63% në 68%, por brengos fakti se humbja e ujit ka shënuar rritje për 3%, apo nga 57 në 60%, që është një indikator jo i mirë.

**Performanca Financiare** e KRU HidroMorava nuk është e lakmueshme pasi humbjet vjetore financiare kanë shënuar rritje për mbi 300 mijë euro nga viti 2009, si rrjedhojë e indikatorëve negativë të rritjes së kostove për 600 mijë euro, edhe pse të ardhurat kishin një rritje për 300 mijë euro nga viti 2009.

**Qeverisja Korporative** dhe respektimi i rregullativave ligjore është një ndër përparësitë më të mëdha në funksionimin e Bordit, duke respektuar kërkesat nga Implementimi i Ligjit mbi NP dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, duke përfshirë këtu raportimet e rregullta ndaj aksionarit dhe komunikimin e rregullt me NJPMNP.

#### D. KRU Hidroregjioni Jugor - Prizren

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Naser Bajraktari	24.12.2008	23.12.2011
Duda Balje	24.12.2008	Ka dhënë dorëheqje
Sahit Ukaj	24.12.2008	23.12.2011
Galip Hoda	24.12.2008	23.12.2011
Bujar Hasani	24.12.2008	23.12.2011
Drita Grazhda	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe disa tregues që dalin nga operimi janë pozitivë si: Gjatë vitit 2010, krahasuar me 2009, është rritur volumi i prodhimit të ujit me m<sup>3</sup>, për 6%, por edhe i ka tejkaluar caqet nga plani i biznesit për 6%. Gjithashtu, është rritur përqindja e inkasimit nga faturimi për 9% më shumë se në vitin paraprak, apo nga 60 në 69%.

**Performanca Financiare** e fund vitit është e mbyllur me humbje financiare prej 533 mijë euro, apo përafërsisht njëjtë sikur në vitin paraprak, edhe pse kishte rritje të të ardhurave totale prej 6% nga viti paraprak, e që këtë rritje e neutralizoi edhe rritja e kostove prej 5%. Shikuar nga aspekti i arritjeve të caqeve nga Plani i Biznesit, ai u arrit me të ardhura, por që fatkeqësisht u rritën edhe kostot që tejkaluan caqet nga Plani i Biznesit për 12%.

**Qeverisja Korporative** dhe respektimi i Kodit të Etikës ishin ndër përparësitë më të mëdha në funksionimin e Bordit, duke respektuar kërkesat mbi mbajtjen e rregullt të mbledhjeve të Bordit dhe Komisionit të Auditimit dhe komiteteve të tjera, duke përfshirë këtu raportimet e rregullta ndaj aksionarit dhe komunikimin e rregullt me NJPMNP.

#### E. KU Radoniqi-Dukagjini - Gjakovë

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Canë Delija	24.12.2008	23.12.2011
Abdullah Kryeziu	24.12.2008	23.12.2011
IsmetNeziri	24.12.2008	23.12.2011
Artan Nimani	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe disa treguesit që dalin nga operimi janë pozitivë si: rritja e përqindjes së inkasimit nga faturimi prej 60%, apo 8% më shumë se në vitin paraprak, ndërsa është tregues jo i mirë se në vitin 2010 u ujitën më pak hektarë tokë bujqësore se në vitin paraprak (kjo arsyetohet me shtimin e reshjeve në 2010), por në fakt arrihen objektivat e parapara për ujitje nga Plani i Biznesit.

**Performanca Financiare** e fund vitit është e mbyllur me humbje financiare prej 29 mijë euro, apo përafërsisht njëjtë si në vitin 2009, dhe nuk është arritur objektivi nga Plani i Biznesit 2010 për një fitim prej 3 mijë euro.

**Funksionimi i Qeverisjes Korporative** nga Bordi i Drejtoreve të kësaj ndërmarrje ishte në vazhden e përpjekjeve të një bordi, i cili është i përgatitur teknikisht dhe shumë i motivuar në angazhimin për mbarëvajtjen e saj, si dhe ka përcjellë respektueshmëri të kërkesave të LNP-së dhe kryerje të detyrimeve fiduciare. Andaj, duke marrë parasysh kushtet e pavolitshme për vijimin e veprimtarisë së kësaj shoqërie dhe mosarritja e objektivave financiar përkundër angazhimit të vazhdueshëm të BD, si edhe respektimit të ligjshmërisë, Kodit të Etikës e shkresave të Aksionarit, konstatohet se ky BD nuk ka mundur që plotësisht t'i përmbushë detyrimet fiduciare ndaj aksionarit.

#### F. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës - PTK

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Rexhë Gjonbalaj	24.12.2008	23.12.2011
Qamil Buzhala	24.12.2008	23.12.2011
Nuhi Ahmeti	24.12.2008	23.12.2011
Elmaze Pireva	24.12.2008	23.12.2011
Sahit Surdulli	24.12.2008	23.12.2011
Gani Sylaj	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi tregojnë se numri i konsumatorëve të Valës ishte rritur për 23 mijë konsumatorë të rinj, në krahasim me 2009, por për t'i arritur objektivat e shprehura të Valës nga plani i biznesit do te duhej që ky numër i konsumatorëve të shtohet edhe për 98 mijë konsumator të rinj. Gjithashtu, kemi rritje të shërbimeve të Postës së Kosovës tek pakot lokale e ndërkombëtare.

**Performanca Financiare** e fundvitit është e mbyllur me fitimin financiar prej 33.3 milionë euro, apo për 11 milionë më pak se në vitin 2009. Pra, objektivat nga caqet e paraqitura në Planin e Biznesit të PTK-së nuk ishin arritur për 12 milionë euro.

Ky rezultat përfundimtar është rrjedhojë e rritjes së kostove prej 14 milionë euro dhe zvogëlimit të të hyrave nga interesi për 11 milionë euro. Pas deklarimit të dividendës, PTK është detyruar të transferoj shumën e dividendës në llogari të aksionarit dhe si rrjedhojë është zvogëluar fitimi bankar i kësaj ndërmarrje.

Shikuar nga prizmi i objektivave të paraqitura në Planin e Biznesit, ky objektivi nuk ishte arritur tek të hyrat për 16 milionë euro dhe tek fitimi i pritur financiar për 12 milionë euro.

Nga aspekti i **Qeverisjes Korporative** dhe respektueshmërisë së rregullativave ligjore, posaçërisht akteve nënligjore, siç janë Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative, të miratuara

nga Aksionari (Kryesuesi i Komisionit të Ministrave për NP), nuk ishin aprovuar nga BD i PTK-së, sipas detyrimit kundrejt aksionarit. Gjithashtu, drejtorët e bordit nuk kanë nënshkruar zotimin për respektimin e LNP, Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, ndonëse deri në miratimin e Kodit, Aksionari, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, u kishte dërguar shkresën me titull: Përgjegjësitë e Bordeve të Drejtoreshave të NP-ve qendrore nr. ZM-294/2009, datë 17.03.2009, e cila ka qenë në fuqi. BD ka paraqitur pranë NJPMNP Kodin e Etikës të miratuar tek në Shkurt 2011, pothuaj 2 vite me vonë. Të dhënat e mësipërme na bëjnë me dije se BD, gjithashtu nuk ka treguar vullnet të plotë për plotësimin e kërkesave të Aksionarit, të ndërlidhura me Letrën e Kryesuesit të Komisionit të Ministrave për NP, aprovimin e vonuar të Kodit të Etikës dhe QK, si dhe ka munguar puna e mjaftueshme e KA.

## Grupi i Bordeve të Drejtorëve që nuk kane Përbushur Detyrat Fiduciare ndaj Aksionarit

### A. KRU Hidrodrini - Pejë

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Shkelzen Hyseni	24.12.2008	23.12.2011
Gjelosh Gojani	24.12.2008	23.12.2011
Elez Hajdari	24.12.2008	23.12.2011
Rexhë Abazi	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi janë jo të favorshëm, pasi prodhimi i ujit ishte i njëjtë me vitin paraprak, por nën objektivat nga Plani i Biznesit për 4%. Gjithashtu, humbja e ujit (uji i pafaturuar) ka rënë nga 74% në 72%, por që prapë është një tregues tepër i pavolitshëm. Shkalla e inkasimit nga faturimi ka rënë nga 60 në 59%, që tregon për një trend jo të volitshëm operativ, sikurse që janë shtuar edhe ankesat nga konsumatorët, ndërsa pothuajse në të gjithë parametrat nuk janë përbushur caqet nga Plani i Biznesit.

**Performanca Financiare** e fund vitit është e mbyllur me humbje financiare prej 235 mijë euro, apo për 341 mijë euro më pak humbje se në vitin paraprak, që ka ardhur si rezultat i rritjes së të ardhurave dhe zvogëlimit të kostove. Indikatorët e arritur financiarë nuk i arrijnë caqet nga Plani i Biznesit çështje e cila duhet adresuar në të ardhmen..

**Funksionimi i Qeverisjes korporative** dhe puna nga Bordi i Drejtoreshave i kësaj ndërmarrje, pothuajse tërë kohën nuk ishte i shoqëruar me rezultate konkrete në performancën e kompanisë dhe treguesi më alarmant operativ, siç ishte humbja e ujit jo që nuk tregoi përmirësim, si rezultat i efektshmërisë së punës së Bordeve, por ky tregues nuk ka shenja të avancimit përkundër investimeve të mëdha nga donatorët. Kur krejt këtyre ia shtojmë edhe problemet me funksionimin e rregullt të punës së bordit, i cili herë-herë ishte i shoqëruar me jopajtuueshmëri mes anëtarëve, marrje të bonuseve të pamërituara me performancë negative, dhe kjo shpesh vinte si rezultat i konfliktit të interesit të një anëtari të bordit, çështje e cila është shqyrtuar edhe nga Agjencioni Kundër Korrupsionit.

## B. KRU Mitrovica - Mitrovicë

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Fehmi Kajtazi	24.12.2008	23.12.2011
Nysret Gërxhaliu	24.12.2008	23.12.2011
Haki Maxhuni	24.12.2008	23.12.2011
Remzi Sylejmani	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe disa tregues që dalin nga operimi janë të favorshëm sa i përket prodhimi i ujit, i cili shprehur në m<sup>3</sup> ishte për 2% më i lartë se në vitin 2009 dhe tejkalim i caqeve nga plani i biznesit për 5.5%, por treguesit tjerë nuk inkurajojnë, si rritja e humbjes së ujit për 2%, apo larg cakt nga Plani i Biznesit për 7%, edhe pse është inkurajues rritja e shkallës së inkasimit nga faturimi prej 4%. **Performanca Financiare** e fund vitit është e mbyllur me humbje financiare prej 382 mijë euro, apo për 100 mijë euro më shumë dhe larg arritjes së caqeve të planit të biznesit për një humbje më të vogël për 270 mijë euro. Rezultati financiar vjetor, si humbje prej 382 mijë euro ka ardhur si rezultat i të ardhurave më të vogla dhe rritjes së kostove prej 2%. Kjo NP kërkon përkujdesje urgjente për ta përmirësuar shkallën e faturimit dhe arkëtimit. Kjo ndërmarrje ka vështirësi specifike në krahasim me ndërmarrjet tjera pasi afro 30% të ujit të prodhuar konsumohet nga Mitrovica veriore dhe nuk arkëtohet, ndërsa niveli i arkëtimit edhe në pjesën tjetër është gjithashtu i ulët.

**Funksionimi i Qeverisjes Korporative** dhe puna bordie të drejtoreve të kësaj ndërmarrje nga fillimi është shoqëruar me vështirësi në vendimmarrje, mos përcjellje të realizimit të vendimeve të tyre dhe vazhdimisht me vërejtje në menaxhment për pasaktësi të raportimeve. Është ndërmarrja me performancën më të dobët mes ndërmarrjeve të tjera për një mori arsyesh objektive (rastet e shumta sociale, mospagesa nga minoriteti serb në zonën e Mitrovicës, vështirësitë në terren), por edhe nga arsye të mosmenaxhimit të mirë të proceseve, nivelit jo efikas të menaxhimit në ndërmarrje, angazhimit jo të mjaftueshëm të BD për ta përdorur si duhet autoritetin udhëheqës dhe profesional, si edhe mungesës së energjisë për të ndërmarrë përgjegjësi sfiduese. Ndërmarrja ka probleme serioze në menaxhimin e burimeve njerëzore, funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, mangësinë e theksuar në politika e procedura të brendshme, si dhe mosfunksionimin e llogaridhënies. Vështirë të vlerësohet pozitivisht aftësia e këtij BD për t'i kryer përgjegjësitë fiduciare të kërkuara nga LNP.

## C. KRU Radoniqi - Gjakovë

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Ruzhdi Kepuska	24.12.2008	23.12.2011
Agim Gjoshi	24.12.2008	23.12.2011
Hajdar Grezda	24.12.2008	23.12.2011
Leonard Shehu	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi sa i përket prodhimit të ujit, i cili ishte në m<sup>3</sup> më i mirë se në 2009 dhe gati në përputhje me synimet nga Plani i Biznesit, por indikatorë zhgënjyes ishin rritja e humbjes së ujit nga prodhimi nga 55% në 65% në 2010, apo larg synimeve nga Plani i Biznesit, sikurse që kishte rënie të shkallës së inkasimit për 2% nga viti paraprak dhe larg arritjes së caqeve nga Plani i Biznesit për 5%.

**Performanca Financiare** e fundvitit është e mbyllur me humbje financiare prej 508 mijë euro, humbje këto që tani më shumë se tri vite vetëm sa po rriten, ndërsa të gjitha këto po shoqërohen me rritje të kostove operative dhe posaçërisht rritje enorme të kostove për paga, si rrjedhojë e punës jashtë orarit. Pjesëmarrja e kostove të pagave në totalin e kostove operative arrin në 71% dhe kjo është një tregues se sa Bordi nuk ka qenë efektiv të merret me këto dhe të dhëna tjera si rekomandime nga të gjeturat nga auditimi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Qeverisja korporative dhe funksionimi i Bordit të Drejtoreve i kësaj ndërmarrje janë shoqëruar vazhdimisht me konfuzitet në ndarje, jounitet, josinqeritet, ndryshe si të shpjegohet e dhëna se ish KE ka punuar dhe vepruar pas skadimit të kontratës dhe Bordi nuk ka pasur dijeni gati një vit. Dhe kjo pastaj ka sjellë tek problemet me përzgjedhjen e KE, bllokimin e procesit me qëllim të imponimit të mendimit në përzgjedhje të KE nga ana e kryesuesit, i cili në fund nga mosrealizimi i synimit të tij tenton bllokimin e funksionimit të Bordit me paraqitje të dorëheqjes mu para skadimit të mandatit. Këto dhe të dhëna të tjera mbi mosrespektimin e kodit dhe ligjit mbi ndërmarrje publike, si dhe rezultatet e vobekta të ofrimit të shërbimeve nga kompania janë tregues të mjaftueshëm që ky Bord nuk ka përmbushur detyrat fiduciare ndaj Aksionarit.

#### D. KU Drini i Bardhë - Pejë

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Ali Sefaj	24.12.2008	23.12.2011
Fadil Kabashi	24.12.2008	23.12.2011
Beqir Metaj	24.12.2008	23.12.2011
Shkodran Gaxherri	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi tregojnë se gjatë vitit 2010 janë ujitur 2760 hektarë tokë bujqësore, apo për 618 hektarë më shumë, por mënyra e ujitjes dhe kanalet e ujitjes shumica janë të modelit të vjetër, që kërkon edhe kosto edhe mund më shumë.

**Performanca Financiare** e fundvitit është e mbyllur me humbje financiare prej 73 mijë euro, apo për 10 mijë euro më shumë se në vitin paraprak, apo më shumë se synimet nga Plani i Biznesit për 13 mijë euro. Ky rezultat është shoqëruar me rritje të të ardhurave, por edhe me rritje të shpenzimeve.

**Qeverisja korporative** dhe funksionimi i Bordit të Drejtoreve tek KU Drini i Bardhë duket se nuk sheh asnjë zgjidhje në morinë e problemeve operative, organizative dhe menaxheriale, por duket pa ide dhe pa energji për ta përmirësuar sadopak situatën dhe sidomos për ta motivuar stafin. BD, në përgjithësi, Komisioni i Auditimit ka mangësi kompetencash teknike, profesionaliteti dhe energjie për të dhënë shtysë në këtë situatë dhe nuk është në gjendje t'i

përmbushë detyrimet fiduciare e as kërkesat e LNP. Interesi në vazhdimësinë e aktivitetit të kësaj shoqërie kërkon masa të rëndësishme nga Aksioneri. Me gjithë përpjekjet e kryera, nuk ka arritur t'i plotësojë detyrat fiduciare të kërkuara nga Aksionari.

#### E. Kompania për Menaxhimin e Deponive të Mbeturave në Kosovë - KMDK

Emri	Data e emërimit	Data e skadimit
Asllan Vitaku	24.12.2008	23.12.2011
Naim Ferati	24.12.2008	23.12.2011
Bajram Limani	24.12.2008	23.12.2011
Makfire Osmani	24.12.2008	23.12.2011
Isak Rakovica	24.12.2008	23.12.2011
Eset Rama	24.12.2008	23.12.2011

**Performanca Operative** dhe treguesit që dalin nga operimi tregojnë së gjatë vitit 2010 janë deponuar 192 mijë ton, apo 10 mijë ton më shumë se në vitin 2009, por që gjendja e deponive, sidomos në Mirash dhe Veleknicë është e nderë dhe karakterizohet me jo trajtim të duhur të mbeturinave, vetëndezje të tyre, lirim gazrash dhe kanosje helmimi të punëtorëve dhe qytetarëve.

**Performanca Financiare** e fund vitit është e mbyllur me humbje financiare prej 960 mijë euro, apo e rritur si humbje për dyfishin sa ishte në 2009, me rritje të të hyrave prej 2% nga viti paraprak, por me rritje të kostove prej 24% nga viti paraprak. Kjo sjellë deri te një gjendje jostabile financiare e kompanisë, e cilësuar me performancë negative.

**Qeverisja Korporative** dhe funksionimi i Bordit të Drejtorëve të KMDK, si duket nuk kanë asgjë të përbashkët, pasi Bordi është i njohur si një Bord i pavendosur në marrje vendimesh, i futur në konfuzitet në interpretimin e ligjeve dhe shumë interes për marrje të bonuseve, me arsyetimin për performancë të kompanisë, përkundër vërejtjeve të dhëna nga NJPMNP.